



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 29

Datë: 10. 06. 2017, ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së
2. Vendim për shqyrtimin e rekomandimit të Listës Votuese për votim jashtë vendit.
 1. Të ndryshme.

1. Hyrje

Mbledhja, është kryesuar nga kryetarja, znj. Valdete Daka.

Enis Halimi: Ju informoj se, në orën 10, sot ka filluar procesi i hapjes së zarfeve të fletëvotimeve të ardhura me postë. Procesimi i tyre, është Brenda afatit, megjithëse ne presim që të arrijnë edhe zarfe, pas kalimit të afatit. Vonesa e tyre, meqë ato vijnë me postë, është e mundur. Ne, daum ta kemi vendimin e KQZ-së se, si do të veprojmë me këto zarfe sepse, logjikisht ato do të jenë pas dates 10 qershor, 2017.

Besnik Buzhala, departamenti i Listës Votuese tha se, ekziston një praktikë dhe ne presim që të arrijnë zarfe, edhe pas afatit. Ne rekomandojmë që të gjithë zarfet që vijnë përmes postës Brenda

afatit ligjor, t'i procedojmë si të rregullta. Ju njoftoj se brenda një zarfi, ka më shumë se një fletëvotim. Mirëpo, ajo që na intereson, është se si ne të veprojmë me zarfet që, do të vijnë pas afatit që skadon sot.

Eshref Vishi: Mendoj se ne duhet të kemi një vendim të qartë. Pas afatit, nuk duhet t'i prajojmë ato sepse, në të kundërtën duhet t'i pranojmë edhe tjera nëse vijnë, duhet t'i pranojmë të gjitha...

Betim Gjoshi: Si do të veprojmë, a mundemi që edhe nesër me vendos për këtë....?

Adnan Rrustemi: Unë mendoj, jo..., propozoj që këto 3573 fletëvotime të aprovohen, dhe të tjera nëse vijnë pas afatit, mos t'i aprovojme...

Valdete Daka: Të pranohen në fakt, vetëm ato zarfe që kanë ardhur deri me datën 10 qershor 2017, sepse ky është afat ligjor dhe ne nuk mund ta shkelim atë... T'i aprovojme këto që kanë ardhur, dhe të tjerat nuk duhet t'i pranojmë...Do t'i pranojmë vetëm ato zarfe që do të vijnë me kohë sepse, po ashtu, jemi në zgjedhje të parakohëshme dhe afati është i shkurtër, nuk kemi kohë...

Anëtarët e KQZ-së, morën vendim që fletëvotimet nga jashtë të pranohen sipas afatit ligjor, deri më 10 qershor 2017. Pas skadimit të këtij afati, nuk do të pranohen.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
